

UDHËZIM
Nr.11 datë 17.8.1993

**PËR DOKUMENTACIONIN DHE KUSHTET E KONTRATËS PËR ANKANDIN
E HAPUR DHE TË KUFIZUAR PËR BLERJET PUBLIKE**

Me propozimin e Ministrise së Tregtisë dhe Bashkëpunimit Ekonomik me Jashtë, dhe në zbatim të vendimit të Këshillit të Miistrave nr.467, datë 17.8.1993 "Për procedurat e prokurimit me fonde shtetërore", Këshilli i Ministrave

U D H Ë Z O N :

I. DOKUMENTACIONI DHE KUSHTET E KONTRATËS Për ANKANDIN E HAPUR

Në organizimin e ankandit të hapur enti prokurues duhet të sigurojë garë të lirë dhe të barabartë ndërmjet konkurruesve, njëri nga të cilët do të fitojë të drejtën e lidhjes së kontratës. Enti prokurues duhet të përgatitë dokumentacionin përkatës të nevojshëm për realizimin e ankandit, i cili përbëhet nga:

1. Njoftimi. Enti prokurues njofton shpalljen e ankandit për prokurimin e një objekti të caktuar. Njotimi vë në dijeni firmat e ndryshme brenda e jashtë vendit për mënyrën e sigurimit të të dhënave të tjera më të hollësishme dhe si duhen të paraqiten ofertat. Publikimi është hapi i parë dhe shumë i rëndësishëm për zhvillimin e gjithë procedurës së ankandit.

Njoftimi përmban: numrin e referencës, burimin e fondit, objektin e prokurimit, shkurtimisht të dhëna të përgjithshme për objektin e prokurimit, adresën e entit prokurues, ku dhe si do të sigurohen dokumentet e ofertës dhe pagesa e tyre, shoqërimi i dokumenteve me një garanci bankare të ofertës dhe pagesa e tyre, shoqërimi i dokumenteve me një garanci bankare të ofertës (2 për qind e vleftës së ofertës së objektit të prokurimit), afati i fundit i paraqitjes së ofertës, vendi, data, ora e hapjes së ofertave dhe pjesëmarrja në hapjen e tyre.

Të interesuarve që shprehin interesin e tyre për njoftimin, pasi bëjnë pjesën e dokumenteve të ankandit, enti prokurues u dërgon këto dokumente:

Përmbajtja e dokumenteve :

2. Ftesa: është letra shoqëruese e dosjes së plotë të dokumenteve të ankandit dhe bën përsëritjen e tekstit të njoftimit të drejtuar konkurruesve.

3. Instruksioni për paraqitësit e ofertave. Enti prokurues informon konkurruesit se çfarë duhet të përmbajë dhe si duhet të paraqitet oferta.

Instruksioni përmban: a) përshkrimin : burimin e fondit dhe përgjegjësia e shpenzimeve të ofertës; b) personin që do të pranojë ofertat dhe do të bëjë sqarimet e duhura; c) dokumentet e ofertës : përmbajtja e dokumenteve, sqarimet dhe amendamentet;

ç) përgatitja e ofertës : gjuha që do të përdoret, dokumentet që duhet të përfshijë oferta, dokumenti i angazhimit për plotësimin e detyrimeve kryesore të ofertës, monedha, kërkesat ndaj firmave, garancia bankare e ofertës, periudha e vlefshmërisë së ofertës, nënshkrimi i ofertës; d) paraqitja e ofertës: vulosja dhe mbishkrimet e zarfëve të ofertës, afati i fundit i paraqitjes së ofertave, anulimi i ofertave që vijnë më vonë, modifikimet dhe tërheqja e ofertës; dh) hapja dhe vlerësimi i ofertave: hapja e ofertave nga enti prokurues, sqarimi i ofertave, kriteret e vlerësimit, vlerësimi paraprak, kthimi në një monedhë të vetme, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave; e) lidhja e kontratës:

paskualifikimi, të drejtat e entit prokurues për të ndryshuar sasi të, për të pranuar ofertat dhe për t'i refuzuar ato, shpallja e lidhjes së kontratës, nënshkrimi i kontratës,(10 për qind e vleftës së kontratës).

4. Kushtet e përgjithshme të kontratës. Këto kushte paraqesin rregullat që duhet të

zbatohen, kushtet tregtare e ligjore etj.

Kushtet e përgjithshme përmbajnë: përcaktimet bazë, standardet që do të përdoren, garancia bankare e përmbushjes së detyrimeve të kontratës, inspektimi dhe provat, ambalazhimi, livrimi i objektit të prokurimit dhe dokumentet përkatëse, sigurimi, transportimi, pjesët e ndërrimit, instalimi, mirëmbajtja, garancia e objektit të prokurimit nga prodhuesi, pagesa, çmimet, amendamentet e nevojshme të kontratës, vonesat në përmbushjen e detyrimeve të furnizuesit, likuidimi i ndërtimeve, forcat madhore, ankimi dhe ligji i aplikimit, taksat e ndryshme.

5. Tabela përmbledhëse e kërkesave përmban: sasi dhe livrimin e objektit të prokurimit.

6. Dokumenti i angazhimit të plotësimit të detyrimeve kryesore të ofertës dhe tabela e çmimeve përmban : angazhimin e furnizuesit për plotësimin e detyrimeve të ofertës dhe çmimet e objektit të prokurimit.

7. Garancia bankare e ofertës është garancia e lëshuar nga banka e furnizuesit për angazhimin e furnizuesit për plotësimin e detyrimeve të ofertës dhe çmimet e objektit të prokurimit.

8. Specifikimet teknike përcaktojnë saktësisht të gjitha të dhënat e plota të objektit të prokurimit. Saktësia e specifikimeve teknike është mjaft e rëndësishme për të lidhur kontratë për objektin e prokurimit të kërkuar nga enti prokurues. Për specifikimet teknike duhet mbajtur parasysh:

a) Specifikimet teknike të përshkruajnë dhe karakterizojnë në mënyrë të saktë e të plotë objektin e prokurimit.

b) Të përmbajë eventalisht kërkesat lidhur me ambalazhimin. etiketimin, marketimin, kontrollin, provat, afatet e garancisë, kushtet e garancisë, asistencën teknike.

c) Të parashikojnë eventalisht grupe në lloje, ndarje në paketë e ndarje në faza.

ç) Kërkesat teknike e cilësore, simbolet dhe terminologjia të shprehen sa të jetë e mundur më shumë në përputhje me standardet.

d) Për të krijuar sa më shumë mundësi për pjesëmarrjen e firmave me garën në dokumentet e ofertës specifikimet teknike të jepen me diapazon dhe të mos përmendet elementi i tipit, markës, origjinës etj.

9. Garancia e përmbushjes së detyrimeve kontraktuese të furnizuesit është garancia bankare e lëshuar nga banka e furnizuesit kundrejt pagesës së tij (10 për qind të vlefës së kontratës), paraqitet nga ai tek enti prokurues para lidhjes së kontratës dhe është e vlefshme me periudhën e garancisë së objektit të prokurimit.

10. Formulari i kontratës.

II. DOKUMENTACIONI DHE KUSHTET E KONTRATËS PËR ANKANDIN E KUFIZUAR

Enti prokurues duhet të përgatitë dokumentin përkatës të nevojshëm për realizimin e ankandit të kufizuar, i cili përbëhet nga :

Përgatitja e dokumentacionit të ftesës për paraqitje oferte përbëhet nga:

1) Përshkrimi dhe instruksioni

- Burimi i fondit

- Objekti i prokurimit.

- Numri i referencës.

- Adresa e entit prokurues.

- Instruksioni që oferta të paraqitet në formën e faturë proformes në dy kopje, e shoqëruar me dokumentacionin përkatës teknik dhe katalog për çdo objekt prokurimi.

- Shoqërimi i dokumenteve në garancinë bankare të ofertës.

- Afati i fundit i paraqitjes së ofertës, vendi, data, ora e hapjes së ofertave, pjesëmarrja.

- Mënyra e dorëzimit të ofertës.

2) Kushtet e furnizimit

- Çmimi: çmimet për firmat lokale do të kuotohen në lekë, kurse me firmat e huaja në monedhën e vendit të konkuresit ose në një monedhë tjetër. Kuotimi në monedha të tjera do të konvertohet me kursin e datës së vlerësimit të ofertave. Çmimi do të jetë i pandryshuar deri në livrimin e plotë të objektit të prokurimit.

- Pagesa: pagesa do të bëhet pas paraqitjes së dokumenteve të ngarkimit, nëpërmjet çeljes së L/C të konfirmuar dhe të pakthyeshme të hapur nga një bankë shqiptare në favor të bankës së furnizuesit.

Kushtet e livrimit: Çmimet që do të kuotohen për dorëzimin e objektit të prokurimit do të jenë sipas INCOTERMS 1990 (standard ndërkombëtar i termave tregtare).

- Koha e livrimit : sa më e shkurtër, jo më shumë se 60 ditë.

- Garancia : objekti i prokurimit i kontraktuar duhet të mbulohet në një garanci të prodhuesit për një periudhë jo më pak se 12 muaj.

- Garancia e përmbushjes së detyrimeve : përpara lidhjes së kontratës dhe çeljes së L/C furnizuesit i kërkohet garancia e përmbushjes së detyrimeve.

- Inspektimi dhe kontrolli i bërë nga prodhuesit, duke paraqitur edhe certifikatën përkatëse.

- Instalimi, nëse kërkohet nga blerësi.

- Mirëmbajtja, nëse kërkohet nga blerësi.

- Orgjina nëse kërkohet të dihet nga blerësi.

- Vlefshmëria: vlefshmëria e ofertës jo më pak se 60 ditë nga data e afatit të fundit e paraqitjes së ofertës.

_ Ligji i aolikimit.

3) Specifikimet teknike. Specifikimet teknike përcaktojnë saktësisht të gjitha të dhenat e plota të objektit të prokurimit.

Saktësia e specifikimeve teknike është mjaft e rëndësishme për të lidhur kontratë me objektin e prokurimit të kërkuar nga enti prokurues. Për specifikimet teknike duhet mbajtur parasysh:

a) Specifikimet teknike që përshkruajnë dhe karakterizojnë në mënyrë të saktë e të plotë, marketimin, kontrollin, provat, afatet e garancisë, kushtet e garancisë dhe asistencën teknike.

c) Të parashikohen eventalisht në lloje, ndarje në paketa e ndarje në faza.

ç) Kërkesat teknike e cilësore, simbolet dhe terminologjia të shprehen sa të jetë e mundur më shumë në përputhje me standardet.

d) Për të dhënë sa më shumë mundësi pjesëmarrësve të firmave në garën në dokumentet e ofertës specifikimet teknike të jepen me diapazon dhe të mos përmendet elementi i tipit markës, origjinës etj.

4. Përpilimi i listës së konkurrenësve që do të ftohen për të marrë pjesë në paraqitje të ofertës.